

# Intervista e kreut të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Gent Ibrahimi për Euronews Albania

POSTED 24/06/2020 KLP



Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Gent Ibrahimi ka qenë i ftuar në studion e lajmeve të Euronews Albania në programin ‘Ilva Now’ drejtuar nga gazetaria Ilva Tare ku ka folur lidhur me problematikat dhe sfidat që kanë hasur institucionet e reja të dala nga reforma në drejtësi.

Kur kanë kaluar katër vjet nga miratimi i reformës në drejtësi kreu i KLP-së pohoi se vonesat në ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë kanë ardhur për shkak të procesit të Vettingut. Sipas tij, shumëçka ka ndodhur por ka ndodhur më pak se sa pritje dhe kjo për arsyen kryesore se nuk ishin marrë parasysh vështirësitë që do të haseshin në procesin e Vettingut. Ibrahimi u shpreh se, procesi mund të përshpejtohet pasi deri tani nuk ka pasur ritmin që të gjithë kanë pritur.

## Intervista e plotë

**Jemi 4 vjet nga miratimi i Reformës në Drejtësi. Bashkë kemi bërë emisione pa filluar reforma, kemi folur për nevojën për ndryshimet Kushtetuese, më pas dolën tek ajo Kushtetutë që ka në trup institucionet e reja të drejtësisë, por p.sh SPAK nuk e ka ende numrin e prokurorëve që duhej të kishte 15, BKH nuk është ngritur ende, çfarë po ndodh, pse këto vonesa?**

**Gent Ibrahimi:** Nuk ballafaqohem shpesh me data dhe shifra dhe ju falenderoj sepse në fund të fundit është detyra juaj që të kujtoni kohën që kalon, numrat që ndonjëherë nuk janë edhe aq premtues dhe vërtet 4 vite është një kohë e gjatë. Në verën e 2016 filloi gjithë kjo

procedurë e stërzgjat, filli zbatimi i reformës në drejtësi, e cila u sanksionua nga Kushtetuta, u detajua më tej me ligjet që vijuan, por janë vërtetë 4 vjet, shumëçka ka ndodhur, por ka ndodhur më pak nga sa pritej të ndodhte. Unë mendoj se arsyeja kryesore është mos bërja e llogarive siç duhej me kohën dhe vështirësinë që paraqet procesi i Vettingut.

Padyshim që Vettingu është diçka që të gjithë e kërkonin dhe në fund ne e morëm, por ndoshta në atë kohë askush nuk ishte në gjendje të parashikonte me saktësi se çfarë vështirësish dhe çfarë afatesh kohore do të kërkonte procesi i Vetting. Si arsye kryesore për këtë pengesë do të quaja procesin e Vetting.

**A ka një mënyrë për ta përsheptuar procesin, të shtohet trupa që bën Vetting-un, sepse me këtë ritëm do të duhet edhe 15 vjet që të përfundojmë?**

**Gent Ibrahim:** Është e vërtetë që procesi i Vetting nuk ka pasur ritmet e pritura nga të gjithë, A duhen përsheptuar ritmet? Përgjigjja s'mund të jetë veçse PO. Kur shtrohet pyetja "SI" atëherë këtu mund të kemi pikëpamje të ndryshme. Padyshim që konsolidimi i institucioneve të Vetting është një nga mënyrat se si arrihet te përsheptimi i procesit të Vetting-ut. Tashmë mund të themi se institucionet janë të konsoliduara, ata po veprojnë prej pothuajse 3 vitesh dhe në këto kushte njerëzit kanë fituar ekspertizën e duhur, procedurat administrative kanë fituar automatizimin e duhur, kështu që mund të themi se kemi shteruar atë shpejtësi që mund të vinte nga konsolidimi i institucioneve të Vetting-ut. Duhet eksploruar mënyra të tjera, mesa duket shtimi i anëtarëve të organeve të Vetting, pse jo, por kjo është pak e vështirë duke pasur parasysh vështirësitë në krijimin e organeve në radhë të parë, por edhe faktin që do të ishte një mundësi e re për politikën për të ndërhyrë në caktimin e njerëzve që do të shërbenin në organet e Vetting. Unë mendoj se kjo duhet lënë mënjanë për shkak të implikimeve dhe vështirësive që paraqet, por shtimi i kapaciteteve njerëzore në organet e Vetting dhe një buxhet i tyre, padyshim që është një mënyrë që duhet eksploruar për të pasur rezultate më të larta dhe një shpejtësi më të madhe nga ana e Vetting.

**Mbetemi pak te Byroja Kombëtare e Hetimit, ku jemi me krijimin e saj?**

**Gent Ibrahim:** Faktikisht KLP ka një rol episodik, marginal në krijimin e BKH. Është vetë SPAK, pra trupa e prokurorëve, që ka rolin kryesor për krijimin e BKH. Kujtoj që BKH është një trupë e specializuar e policisë gjyqësore, e atashuar pranë trupës së prokurorëve. Proces i krijimit të BKH fillon me emërimin e drejtorit të BKH dhe kjo është një kompetencë që e ushtron KLP. Pra jemi ne që në fund emërojmë X apo Y si drejtues të BKH. Por kjo nuk është aq sa duket sepse ne na paraqitet 1 kandidaturë dhe ne kemi të drejtën ta emërojmë ose ta rrëzojmë atë kandidaturë.

**Nga ju vjen kandidatura?**

**Gent Ibrahim:** Kandidatura vjen nga vetë SPAK. Brenda SPAK është krijuar një trupë me 3 anëtarë, dy prej të cilëve janë prokurorë të Prokurorisë Speciale dhe i treti është një gjyqtar i Gjykatës së Posaçme. Këta të tre janë përgjegjës për procesin e përzgjedhjes së kandidatëve dhe është një proces i përbërë nga disa etapa. Pjesa më e madhe e etapave është konsumuar. Sot që flasim ata kanë arritur të identifikojnë një rreth të ngushtë me 4 kandidatë dhe ata janë në procesin e Vetting, që është i ndryshëm nga ky vetting i madh dhe i jashtëzakonshëm që dëgjojmë shpesh.

Desha të theksoj se përveç këtij Vettingut të madh që shohim dhe dëgjojmë, në punën tonë të përditshme ne kryejmë vetting çdo ditë, qoftë KLP, KLGJ, SPAK në rastin e përzgjedhjes së Drejtorit të BKH, por edhe për oficerë të BKH. Ky është një Vetting që konsiston me një korrespondencë me rreth 35 institucione, 35 zyra, që synon të nxjerrë në pah integritetin e kandidatëve, rregullsinë e pasurisë së tyre dhe anën profesionale.

### **Nuk ka një afat se kur do të përfundojë?**

**Gent Ibrahimi:** Kjo është një punë që po e kryejnë ata jo ne. Sigurisht që ne jemi të interesuar mbi atë që po ndodh dhe ajo që kam mësuar nga SPAK është se ne rreth mesit të muajit korrik do të kemi kandidatin e përzgjedhur prej tyre dhe ky kandidat do të emërohet nga KLP, në rast se Këshilli e gjykon kandidatin atë të duhurin.

### **KLP është në këtë rast vetëm në rolin noterizues, do ta pranoj ose jo, apo ka të drejtë ta kthejë nëse nuk i pëlqen?**

**Gent Ibrahimi:** Padyshim që ka të drejtë ta kthejë, por mundësitë tona për ta kthyer janë të minimizuara, sepse ne nuk jemi përfshirë në procesin e përzgjedhjes, ne nuk e dimë si krahasohet kandidati që na paraqesin ne në raport me kandidatët e tjerë, të cilët janë rrëzuar gjatë rrugës, kështu që ajo që do të shohim ne është ajo nëse ka ndonjë gabim të rëndë në procedurën e përzgjedhjes së kandidatit, për ndonjë arsye apo tjetër është neglizhuar plotësimi i ndonjë prej kushteve ligjore nga ana e kandidatit, është shkelur procedura apo jo. Pra kemi një rol formal, mund ta quash edhe noterizues. Ne jemi të vetëdijshëm se kemi një rol dytësor në këtë proces.

### **Çfarë ndodh pas zgjedhjes së Drejtorit të BKH?**

**Gent Ibrahimi:** Atëherë ndodh ngritja e BKH dhe siç mund ta kuptoni afatet fillojnë edhe shtyhen. BKH do të ketë në përbërje të saj rreth 60 oficerë të policisë, që do të zgjidhen përmes një procedure kompetitive.

### **A ka nisur një proces paralel?**

**Gent Ibrahimi:** Jo nuk ka nisur, është e pamundur, sepse e nis kryetari në momentin që zgjidhet. Drejtori i BKH është personazhi kryesor në momentin e përzgjedhjes së anëtarëve të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Është procesi përzgjedhës, por edhe ai i Vetting-ut të tyre.

### **Sa kohë mund të shkojë procesi i zgjedhjes së tyre?**

**Gent Ibrahimi:** Unë jam bërë pak famëkeq për sa i takon parashikimeve të dështuara. Parashikimet që unë kam bërë në të kaluarën herë pas here për sa i takon krijimit të SPAK, zgjedhjes së Prokurorit të Përgjithshëm janë kushtëzuar nga ecuria e procesit të Vetting. Unë mund të bëj vetëm një projeksion të përafërt të kësaj kohe, por sidoqoftë dua të them se përpara fundit të këtij viti, do ta kemi BKH në punë. Në mos të gjithë strukturën e plotë prej 60 oficerësh, një pjesë të rëndësishme të saj duhet ta kemi në punë përpara fundit të vitit.

**Dhe mund të quhet në momentin që ngrihet BKH dhe kemi edhe SPAK, me shpresën që do e kemi me 15 prokurorët, që drejtësia e re mund të eci me këmbët e veta, apo do të penalizohet me faktin se ende nuk kemi Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë?**

**Gent Ibrahim:** Jo besoj se SPAK dhe BKH janë kushte të mjaftueshme që drejtësia e re të eci me këmbët e veta, siç e thatë ju. Unë shpresoj që të jem gjithmonë e më pak i kërkuar nga mediat në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e SPAK dhe BKH. Është e vërtetë që këto institucione është presupozuar të jenë të vetë organizuara, të vetëqeverisura dhe të përgjegjshme përballë publikut, Kuvendit, por edhe përballë KLP-së. Padyshim të gjithë ne shpresojmë që SPAK në momentin që të gjitha kushtet e kërkuara nga ligji, por edhe objektivisht në mirëfunksionimin e tyre, në momentin që të gjitha kushtet janë ezauruar, të fillojë të funksionojë me kapacitet të plotë. Nuk më pëlqen të jem apolagjetik, shfajësues në raport me ta, por më duhet të them se ne ende nuk i kemi mbaruar të gjitha detyrimet tona në raport me SPAK.

**Çfarë detyrimesh më thoni, sepse SPAK ka 6 muaj që ekziston, por nuk është parë ndonjë rezultat spektakolar, mos duket kishim ngritur shumë pritshmëritë te këto institucionet e reja?**

**Gent Ibrahim:** Mundet, ndoshta SPAK mund të kishte qenë pak më i zhdërvjellët në marrëdhëniet me publikun. Besoj objektivisht se SPAK ka më pak se 6 muaj, duhet të llogarisim këtu edhe kufizimet që erdhën gjatë dy muajve të fundit, sidoqoftë, çdo strukturë e re që krijohet ka nevojë për mbështetje dhe besimin e opinionit publik. Dhe ndoshta besimi i opinionit publik duhet të ishte ushqyer pak më mirë nga SPAK. Por duke lënë mënjanë këtë, kjo është një çështje taktike, unë mendoj se SPAK ende nuk mund të gjykohej për performacë të ulët, të mesme apo të lartë, që nuk është rasti siç e thatë edhe ju në këtë rast. Ka ende shumë detyrime që rëndojnë mbi Kuvendin, mbi Vetting, mbi KLP ndaj SPAK.

**Çfarë detyrimesh ka Kuvendi ndaj SPAK?**

**Gent Ibrahim:** Kuvendi ka detyrimin për të rishikuar pagat e SPAK. Për sa kohë SPAK nuk ekzistonte ende, ishim ne KLP, që jemi bërë sponsorë të nevojës për të rritur pagat e prokurorëve të SPAK. Ne kemi qenë kontributorët e një amendamenti në ligjin për statusin ku kërkohej rritja e pagave, por ky ligj u kthye nga Presidenti i Republikës jo për shkak të pagave të SPAK, nuk kishte kundërshtim, por ai kishte kundërshtim për formulën e betimit, dhe si të thuash në këtë rast u dogj i njomi me të thatin, dhe propozimi për rritjen e pagës së SPAK u la mënjanë. Tani që SPAK është krijuar e ka marrë vetë nismën për ndryshimet ligjore, kanë propozuar nismën për disa ndryshime në ligjin për SPAK, të cilat duhet të bëhen dhe ne të gjithë jemi koshientë për rëndësinë e veçantë të kësaj strukture. Ne kemi pritshmëri shumë të mëdha te kjo strukturë dhe padyshim ne si shoqëri duhet të bëjmë pjesën tonë. Këtë duhet ta bëjë Kuvendi. Ne si KLP duhet të bëjmë plotësimin e strukturës. Është e vërtetë që ne i kemi përzgjedhur ata 15 prokurorët që do të duhet të shërbejnë në SPAK, por këta e kanë kaluar procesin e Vetting në faza të ndryshme me shpejtësi të ndryshme dhe ne pritëm deri në fund të dhjetorit, atëherë kur patëm një numër të arsyeshëm për të filluar punën, por ende nuk jemi në gjendje të plotësojmë organikën prej 15 prokurorësh. Ky është një vendim që kemi marrë ne, që SPAK duhet të kishte 15 prokurorë.

**Pse s'kemi pasur mundësi ta plotësoni?**

**Gent Ibrahim:** Sot që flasim në SPAK shërbejnë 12 nga 15 prokurorë. Këtë strukturë e kemi vendosur ne, pra përbërjen me 15 prokurorë. Në të ardhmen këtë strukturë nuk do e vendosim ne, por vetë SPAK në marrëdhënie të drejtpërdrejta me Kuvendin, do të vendosi për strukturën dhe organikën e SPAK. Pra do të jenë 15, 18 apo 20 prokurorë, kjo do të jetë puna e tyre. Ne kemi qenë ata që kemi marrë vendimin e parë, pasi nuk kishte kush ta merrte tjetër.

Ne kemi përzgjedhur 15 kandidatë, disa prej tyre nuk e kanë kaluar vetting, disa janë ende në procesin e Vetting dhe në këto kushte ata janë detyruar të shërbejnë me një organikë nën atë që është parashikuar në strukturë. Ka edhe detyrime të tjera që janë ende në proces, p.sh krijimi i BKH është faktori kryesor.

**Z. Ibrahim, ju jeni një nga bashkë hartuesit, jeni marrë me pjesën e reformës, institucionet e reja dhe mënyrës sesi janë ndërtuar ato. A do të kishit bërë diçka ndryshe?**

**Gent Ibrahim:** Paradoksalisht kam menduar më shumë për reformën atëherë kur nuk isha pjesë e strukturave të drejtësisë së re, tani që jam këtu kam një fokus veprimi më të ngushtë dhe jam i përqendruar 100 % në këtë drejtim, dhe ndonjëherë më shpëtojnë zhvillimet në fusha të tjera si me Gjykatën Kushtetuese, KLGJ, ILD, gjithsesi nuk mund të them se jam i painformuar. Për tu kthyer te pyetja juaj, nëse do të kisha bërë ndonjë gjë ndryshe, unë vazhdoj të besoj në mënyrë fanatike te fakti që arkitektura e sistemit tonë të drejtësinë, e cila është konceptuar me Kushtetutën e 2016, është e shkëlqyer.

Nuk ka të dytë në Evropë për sa i takon nivelit të mendimit dhe thellësisë së mendimit që ka paraprirë këtë konfiguracion, këtë strukturë, këtë arkitekturë të sistemit tonë të drejtësisë.

**Por, a nuk keni dyshimin se është një arkitekturë e mirë në letër, por e vështirë për tu zbatuar duke pasur parasysh edhe burimet njerëzore, kapacitetet, kriteret që janë vendosur për të kaluar vetting, të cilat janë thujse të pamundur për tu kaluar, duke pasur parasysh dhe nga cila Shqipëri vinim, nga Shqipëria e mos pagesës së taksave, nga Shqipëria e informale etj. A duhej ti kishit marrë parasysh këto?**

**Gent Ibrahim:** Patjetër çdo gjë që nuk ecën me ritmin e duhur është dëshmia përfundimtare e faktit që nuk është menduar aq mirë sa duhet kur janë bërë planet. Për sa më takon mund të pranoj përgjegjësinë për këtë. Ajo që mund të them është që mënyra se si zbatohet një koncept, siç është koncepti që qëndron në themel të sistemit tonë të drejtësisë komprometohet pjesërisht nga imperfeksionet në fazën e konceptimit, por më shumë se kaq nga imperfeksionet në fazën e zbatimit. Ju ndoshta me të drejtë përmendët nëse e kemi ngritur shumë lart stekën dhe këtu në Shqipëri tonë që vjen nga informaliteti vërtet nuk ka njerëz që i arrijnë këto standard kaq të larta, standarde që janë menduar të zbatohen në vende me ekonomi të stabilizuar, me demokraci të stabilizuar prej shekujsh. Po mund të ishte një përgjigje për këtë pyetje, por nga ana tjetër, Kushtetuta nuk ka qenë kaq ekzigjente në këtë rrafsh. Pra kur ka ardhur puna për kërkesat, për të justifikuar pasurinë, për të justifikuar origjinën e të ardhurave të tua, Kushtetuta thotë shumë qartë: që një magjistrat mos të arrijë të kalojë Vetting do të duhet që ai të ketë një pasuri dy herë më të madhe se sa ajo që arrin të justifikojë me letra. Pse është bërë kjo, a është një indurgjencë nga ana e ligjvënësit? Jo nuk është një indurgjencë. Është një vetëdije për realitetin në të cilin ne jetojmë. Një shoqëri me një shkallë të lartë informale, ku jo çdo transaksion që ne kryejmë është justifikuar me letra. Por kjo vetëdije e ligjëbërësit nuk është zbatuar, nuk është marrë parasysh në zbatim, ose zbatimi i tij ka shkuar në një drejtim tjetër. Ligjëbërësi parashikoi me të drejtë që nëse dikush ka një pasuri dy herë më të madhe se sa ajo që arrin të justifikojë, pra unë justifikoj 100, dhe nëse kam 199 duhej ta kaloja Vetting. Këtë ka thënë Kushtetuta. Në praktikë nuk është marrë parasysh ky përcaktim i Kushtetutës ndaj dhe janë krijuar gjithë këto vështirësi për të siguruar numrin e mjaftueshëm të kandidatëve. Thatësira me të cilën u ballafaqua KED kur erdhi puna të zgjidhte kandidatët për në Gjykatën Kushtetuese është arsyeja e parë dhe e fundit për

dështimin në përzgjedhjen e kandidatëve në këtë gjykatë. Imagjinoni të kishte pasur një burim të mjaftueshëm kandidatësh që do të plotësonin kushtet, për këdo do të ishte më e lehtë puna dhe do të kishim sot 6 anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

### **Por sa e mundur ishte kjo që të mos ishte kjo thatësi?**

**Gent Ibrahimi:** Organet e Vetting janë përgjegjëse për interpretimin e asaj dispozite Kushtetuese, që thotë: që një magjistrat mos të arrijë të kalojë Vetting do të duhet që ai të ketë një pasuri dy herë më të madhe se sa ajo që arrin të justifikojë me letra. Organet e Vetting nuk e kanë interpretuar kështu. KED ka të drejtën të bëjë një interpretim të kësaj dispozite në mënyrën e vet. Pra nëse organet e Vetting janë treguar më ekzigjente seç i ka mandatuar Kushtetuta, sipas gjykimit tim, KED nuk kishte pse ta bënte këtë. Por ndërkohë ata që janë kandidatë të mundshëm për Gjykatën Kushtetuese nuk e dinë se çfarë standardi i pret, nuk e dinë nëse KED do të zbatojë standardin më indulgjent apo më ekzigjente dhe në këto kushte kjo ka përcaktuar edhe thatësinë në prurjet me kandidatë.

### **Z. Ibrahimi a mendoni se ka pasur një tendencë në zbatimin e Vetting për ti shkarkuar gjyqtarët dhe prokurorët, nisur edhe nga perceptimi se pjesa më e madhe e gjyqtarëve dhe prokurorëve ishin të korrumpuar?**

**Gent Ibrahimi:** Nuk e besoj këtë, pavarësisht se perceptimi bën të vetën, procesi i vetting është i rregulluar në mënyrë të imët procedurale, që ofron garanci maksimale për sa i takon të drejtave të atyre që janë subjekte të Vettingut, gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në këto kushte tendenca edhe po që në kokën tënde si anëtar i Vetting është shumë e vështirë të materializohet në vendimmarrje. Unë kam një vlerësim shumë të lartë për organet e Vetting për atë çka kanë bërë, pavarësisht se vazhdoj të them që një efekt anësor negativ i punës së tyre ka qenë interpretimi tepër strikt i dispozitës kushtetuese për dyfishin e pasurisë. Ky është një efekt anësor negativ. Kam një vlerësim maksimal për punën e tyre, sepse ata janë shqiptarë që arrijnë të ndëshkojnë shqiptarë. Tani jam anëtar i një organi vendimmarrës ku ne marrim vendime për statusin e prokurorëve, ku marrim vendime për emërime, shkarkime, për transferimin e tyre, dhe të jeni të sigurtë që është shumë e vështirë që të marrësh vendime për statusin e një individi. Ne jemi porozë nga ana kulturore për sa i takon aftësisë së botës së jashtme për të na influencuar. Në këto kushte që të arrish që të largosh nga sistemi gjysmën e gjyqtarëve dhe prokurorëve është një meritë shumë e madhe e organeve të vetting, që kanë arritur të fusin një kulturë të re të veprimit të ligjit mes nesh. Pra shqiptari që zbaton ligjin mbi shqiptarin është një risi shumë e madhe dhe këtë duhet t'ia dimë për nder vetting.

### **Por i monitoruar nga ndërkombëtarët...**

**Gent Ibrahimi:** Patjetër, i monitoruar nga ndërkombëtarët, por nuk i merr ONM vendimet. ONM ndjek seancat dhe ka të drejtë vetëm të flasë. ONM ka vetëm të drejtën që të bëjë të mundur ankimin. Pra, monitoruesit ndërkombëtarë nuk duhet ti fetishizojmë, ata janë shumë të rëndësishëm, padyshim janë një nga arsyet e suksesit të Vetting në nivelin e goditjes të shkeljeve të ligjit nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve, por vendimet janë të shqiptarëve, i marrin ata. Kështu që në këto kushte duhet të jemi krenarë për këtë.

Ajo që më vjen keq për organet e vetting janë dy gjëra: interpretimi tepër strikt të kërkesës për dyfishin e pasurisë dhe tjetra është që në disa raste kanë goditur persona që kursesi nuk

kanë asgjë të përbashkët me korrupsionin dhe mungesën e integritetit dhe në këtë mënyrë kanë diskretitur në një masë të caktuar procesin.

### **Cilin?**

**Gent Ibrahimi:** Antoneta Sevdari padyshim është një nga, nuk flas në tym, por kam parasysh persona konkretë. Në raste konkrete Vetting ka shkarkuar simbole të integritetit në radhët e magistratëve.

### **A ka zbatuar dy standard vetting në vlerësimin e kritereve dhe kalueshmërisë ose jo?**

**Gent Ibrahimi:** Jo në fakt ka qenë konsistent në zbatimin e standardeve, qoftë edhe mos marrjen parasysh të kërkesës së ligjit për dyfishin e pasurisë.

### **A keni ju informacione apo dyshime se ka qenë nën presion politik organet e vetting për vendimmarrje të caktuara?**

**Gent Ibrahimi:** Ne shqiptarët jemi porozë nga influencat që vijnë nga miqtë, nga politika, biznesi, ndonjëherë edhe nga influenza që vjen si rezultat i korrupsionit. Pra ne jemi një shoqëri që e kemi këtë veçori jo të mirë për fat të keq. Kështu që unë nuk përjashtoj mundësinë që në raport me organet e Vetting, ashtu si edhe në raport me KLP, të ushtrohen influence nga burime të ndryshme, por ju siguroj se këto influenza për shkak të procedurave që ne jemi të detyruar të ndjekim, për shkak të kushteve ekzigjente, të cilat duhet të plotësojnë kandidatët nuk janë kurrë vendimtare. Unë ju siguroj sot se asnjë burrë në Shqipëri, cili është burri më i pushtetshëm sot në Shqipëri? Është Kryeministri i Shqipërisë. Nëse ky burrë vendos që dikush të shkojë diku, mund të bëjë të tijën, por kjo kurrsesi nuk është vendimtare.

### **Ju personalisht keni pasur presion politik, se edhe opozita ju ka sulmuar për shkak të lidhjeve familjare, ju ka kompleksuar në këtë drejtim për të qenë më i favorshëm me mazhorancën?**

**Gent Ibrahimi:** Nuk mund të bëj sikur këto gjëra vijnë anash pa pasur ndonjë efekt. Pa dyshim që unë mundohem ta kontrolloj atë që ju e quajtet kompleks, mendoj se ja kam dalë, por padyshim që është një formë presioni, të cilën duhet ta administroj në radhë të parë profesionalisht në vendin ku ti shërben.

### **Po nga mazhoranca ke pasur presion?**

**Gent Ibrahimi:** Presion jo, padyshim që ata janë politikanë dhe ata përpiqen që influencojnë dhe projektojnë mendimet e tyre në çdo rrafsh të jetës, edhe në përzgjedhjen e kandidatëve. Këto vijnë në formën e opinionëve, të cilat ne kemi të gjithë kapacitetin për ti administruar për shkak të procedurave që ne jemi të detyruar ti ndjekim dhe për shkak të kushteve ekzigjente që duhet të plotësojnë kandidatët. Në këto kushte askush nuk mund të bëjë ditën natë dhe natën ditë.

### **A ka njerëz në KLP në gjykimin tuaj që nuk meritojnë të ishin aty ose që mund të kishte më mirë?**

**Gent Ibrahim:** Pjesës së parë të pyetjes nuk mund t'i përgjigjem sepse në fund të fundit kush jam unë? Unë jam një ndër ata. Por, a mund të ishte më mirë? Padyshim që po. Unë dua të kujtoj që të gjithë ne anëtarët e Këshillit, ne që vijmë nga radhët e laikëve, pra ne jo prokurorët, jemi përzgjedhur gjithashtu në kushtet e një furnizimi të pakët me kandidatë. Procesi i përzgjedhjes që është zhvilluar në radhët e pedagogëve, avokatëve dhe në radhët e shoqërisë civile, ka qenë problematikë sa i takon prurjes së pakët. Dhe ky nuk është një problem i vogël sepse nëse do të kishte një prurje të madhe do të kishte më shumë zgjedhje dhe më shumë cilësi. E dyta, kur ne më në fund shkuam në Kuvend dhe Kuvendi duhet të ushtronte të drejtën e tij për të zgjedhur midis nesh, Kuvendi nuk e ushtroi këtë të drejtë për shkak të opozitës. Opozita nuk e pamundësoi zgjedhjen dhe ne u zgjohem me short, edhe unë jam zgjedhur me short. Kështu që, shorti ka meritën e kufizimit të mundësisë për ndikim politik, por nga ana tjetër lë për të dëshiruar kur vjen puna tek përzgjedhja e më të mirëve. Pra, në këto kushte, po. Mund të kishte pasur edhe përzgjedhje më të mira.

**A mendoni se u bë gabim duke i lënë shteg shpëtimi prokurorëve dhe gjyqtarëve që thjesht të jepnin dorëheqjen?**

**Gent Ibrahim:** Unë e kuptoj që e parë nga jashtë mund të duket si e padrejtë që dikush që me gjasë është korruptuar përgjatë viteve të karrierës së tij si prokuror apo gjyqtar, thjesht për faktin që ka mençurinë që të japi dorëheqjen, shpëton nga çekani i ligjit. Por, duhet të kujtoj që si në çdo aspekt tjetër të jetës edhe këtu duhet bërë llogaria me realitetin. Duhet bërë një ekonomi nëse mund të flas në këtë mënyrë, një ekonomi në mënyrë që sistemi të arrijë të veprojë mbi ata të tjerët që nuk dalin mënjane. Por, nga ana tjetër këta njerëz që shpëtojnë nga veprimi i Vettingut, nuk shpëtojnë nga veprimi i ligjit penal. Jo më larg se disa ditë përpara SPAK ka hapur procedimin penal për dhjetë ish gjyqtarë dhe prokurorë pavarësisht se ata tanimë janë jashtë sistemit për shkak të veprimit të Vettingut.

**A është normale që të mbetemi kaq gjatë pa Gjykatë Kushtetuese dhe Gjykatë të Lartë?**

**Gent Ibrahim:** Ju e dini vetë përgjigjen e kësaj pyetjeje, madje edhe ata që na ndjekin. Përgjigja s'mund të jetë veçse jo. Është katastrofike që ne sot veprojmë me mungesën e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë. Sidoqoftë, unë mendoj se ne i jemi futur një rrugë e cila është e mundimshme, e cila ka kosto. Për mua kostot kryesore janë kostot që pësojnë njerëzit të cilët nuk arrijnë të marrin drejtësinë në kohën e duhur në dyert e gjykatave, por është një rrugë e cila do të na shpjerë drejt zgjidhjeve me themel dhe të qëndrueshme për një afat të gjatë. Kështu që, është një kosto që do të duhet ta mbajmë edhe me pak durim, për të shërbyer më pas me një sistem funksional dhe të drejtë.

**Presidenti Meta ka hartuar një draft-marrëveshje me disa pika u përfshihet reforma në drejtësi. Një prej tyre është edhe përcaktimi i një harte të prokurorive dhe gjykatave të rrethit, të cilat kanë nevojë urgjente për prokurorë apo gjyqtarë për shkak të mungesave që ka sjellë procesi i Vettingut. Ju e keni këtë hartë dhe a ka mjaftueshëm kandidatura për të plotësuar prokuroritë?**

**Gent Ibrahim:** E vërteta është që kjo hartë, pavarësisht se në listën e Presidentit i lihet si detyrë KLGJ-së dhe KLPS-së, në fakt është detyrë e Këshillit të Lartë Gjyqësorë. Kjo sepse sistemi është i ndërtuar në mënyrë të tillë që prokuroritë janë të vendosura pranë gjykatave. Pra, vendimet se ku do të jenë gjykatat janë vendimet e para dhe këto vendime i merr KLGJ. Ne thjeshtë përshtatemi. Padyshim që ne si Këshilli i Lartë i Prokurorisë jemi të informuar për atë çka po ndodh. Di që ata janë në një fazë të avancuar të procesit dhe shumë shpejt do ta



kemi hartën gjyqësore, ku ne si KLP vetëm e zbatojmë atë. Ka të ngjarë që të ketë probleme me personelin gjyqësorë dhe prokurorial për shkak të rrallimit të numrave si rezultat i veprimt të Vettingut. Ne sot shohim që ka zyra nëpër prokuroritë e rretheve që nuk kanë ngarkesën e duhur dhe janë të paktën 4 zyra në republikë që nuk e justifikojnë ekzistencën. Ato do të duhet të atashohen pranë zyrave më të mëdha. Ky informacion i yni padysim që është në dispozicion të Këshillit të Lartë Gjyqësorë dhe ata do ta marrin parasysh besoj kur të vijë fjala për të marrë vendimin e hartës. Ata do të marrin një vendim ku parashikoj se do të sjelli një reduktim të numrit të gjykatave të apelit, për dy arsye. Qoftë për të garantuar një koherencë më të madhe vendimmarrjeje në këtë nivel, pra jo njëra gjykatë gozhdës dhe tjetra patkoit. Sa më shumë konsistencë në marrjen e vendimeve, por nga ana tjetër do të duhet të mbajmë parasysh edhe siç e thashë rrallimin e numrave të gjyqtarëve. Kështu që duhet të jetë një vendim pjesërisht i detyruar.

**A mos ndoshta ka ardhur koha të ndryshohen ligjet dhe të paktën të krijohen institucionet? Duket se shpesh herë iniciative të zëshme apo të pazëshme, kur dëgjojmë Ambasadorin Amerikan, e cila flet për tentativa për të vrarë reformën në drejtësi. A është tabu prekja e ligjeve të institucioneve të reformës në drejtësi?**

**Gent Ibrahimi:** Ligjet janë prekur në vijimësi nga viti 2016 e këtej. Ne çdo ditë në zbatimin e ligjit shohim probleme, paqartësi dhe kundërshti. Por, natyrisht nuk mund të nisesh nga gjëra të vogla për të kërkuar ndryshime sa herë që lind nevoja. Ne po bëjmë një punë disi më sistematike dhe mendojmë që në fund të vitit do të kemi një projekt me amendamente që diktohen nga situata. Ajo që unë shoh problematike është ndërhyrja në Kushtetutë. Mendoj që është një ndërhyrje e panevojshme, sepse unë vazhdoj të besoj tek mençuria e arkitekturës institucionale që ne kemi zgjedhur dhe me një kosto shumë të lartë politike. Unë shpresoj që shqiptarët nuk do ti votojnë ata politikanë që fusin duart në Kushtetutë, për të ndryshuar sistemin e drejtësisë, të cilin me aq brohoritje e miratuam në 2016.

**Ju keni informacion që ka iniciativa për të ndryshuar Kushtetutën?**

**Gent Ibrahimi:** Jo, por do ta përjashtoja duke pasur parasysh panevojshmërinë dhe koston shumë të lartë politike të atyre që do të guxonin ta bënin këtë.

Po ndonjë dijeni apo informacion nga erdhi shqetësimi i ambasadores së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në lidhje me tentativat për ta vrarë reformën?

**Gent Ibrahimi:** Jo, jo më vjen keq.

**Do ta mbyllim me pak nota optimizmi?**

**Gent Ibrahimi:** Patjetër. Unë nuk e di se sa optimist apo pesimist tingëllova, por unë mendoj që Reforma në Drejtësi do të japë rezultate dhe është e pamundur të mos japë. Mënyra si është konceptuar sistemi, ndarja e roleve, alokimi i burimeve njerëzore, opozicioni i lehtë mes aktorëve të ndryshëm brenda institucioneve apo institucioneve me njëra-tjetrën, janë zgjidhje optimale sa i takon organizimit të sistemit dhe në këto kushte, unë mendoj se sistemi patjetër do të japë rezultate. Na duhet të kemi dhe pak durim!